



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



LICENCË PËR PRODHIM TË ENERGISË ELEKTRIKE

DHËNË :

“KelKos Energy” SH.P.K

Numri i Licencës: ZRRE/Tr_01/Li_09/17

Prishtinë, 27 prill 2017

PËRMBAJTJA

Neni 1	Qëllimi	3
Neni 2	Përkufizimet	3
Neni 3	Të drejtat dhe detyrimet.....	5
Neni 4	Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Prodhimit.....	6
Neni 5	Shitja e Prodhimit dhe Ndalimi i Ndër-subvencioneve	7
Neni 6	Ndalimi i Abuzimit të Pozitës Dominuese	7
Neni 7	Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit, Kodet e Matjes dhe legjislacionin tjetër në fuqi ..	7
Neni 8	Masat e efijencës.....	7
Neni 9	Dispeçingu Qendror	8
Neni 10	Shërbimet Ndhmëse dhe balancuese	8
Neni 11	Caktimi i Operatorit.....	9
Neni 12	Rregullat e Tregut.....	9
Neni 13	Shëndeti dhe Siguria	10
Neni 14	Mjedisi.....	10
Neni 15	Puna	10
Neni 16	Tjetërsimi dhe Heqja e Aseteve Relevante të të Licencuarit	10
Neni 17	Obligimi i Sigurimit	11
Neni 18	Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit	11
Neni 19	Obligimet e Shërbimit Publik	11
Neni 20	Sigurimi i Informacioneve ndaj Rregullatorit	11
Neni 21	Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës	12
Neni 22	Taksat	
Neni 23	Masat Administrative dhe Gjobat.....	13
Neni 24	Zgjidhja e Kontesteve	13
Neni 25	Hyrja në fuqi.....	14

Neni 1 Qëllimi

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji ZRRE** (në tekstin e mëtejshëm "Rregullatori"), në pajtim me autoritetin e dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Nenin 18 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081) dhe Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017), nëpërmjet kësaj në seancën e datës 27 prill 2017, i ndryshon (modifikon) **ndërmarrjes "Kelkos Energy" Sh.p.k Licencën për prodhim të energjisë elektrike** (me numër licence ZRRE/Tr_01/Li_09/12) në Hidrocentralin (HC) Lumbardh (ish Kozhnjer) me lokacion në Komunën e Deçanit, adresa Rruga Zagrebi 19/22, 100000, Prishtinë, Republika e Kosovës, tani me numër licence **ZRRE/Tr_01/Li_09/17** (në tekstin e mëtejshëm "i Licencuari").
2. Ndryshimi/modifikimi i kësaj licence vjen si rezultat i ndryshimeve të Legjislacionit primar të sektorin të Energjisë: Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085, i cili ka hyrë në fuqi në gusht 2016); Ligjit për Gazin Natyror (Ligji Nr. 05/L-082, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); si dhe Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017, e cila ka hyrë në fuqi me 31 mars 2017).

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptimin si në vijim:
 - a) **Anëtar** - marrëdhënia e drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo Kompani Aksionare apo vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës i ndonjë ndërmarrjeje Aksionare të të Licencuarit, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi.
 - b) **Shërbime Ndihmëse** - të gjitha shërbimet e nevojshme për operimin e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes.
 - c) **Vit financiar** - periudha prej 1 Janar deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.
 - d) **Njësi gjenerimi** - çdo central apo pajisje për gjenerimin e energjisë elektrike.
 - e) **Rregulla të Tregut** - normat të cilat rregullojnë tregtimin e energjisë elektrike ndërmjet pjesëmarrësve në treg dhe marrëdhëniet ndërmjet palëve në tregun e energjisë elektrike, Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit të transmetimit me qëllim të mirëmbajtjes së balancit fizik të tregut;
 - f) **Përgjegjësia e Balancimit** - obligimi i pjesëmarrësve të tregut që të balancojnë gjenerimin, konsumin, blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, në pajtim me oraret e pranuar, dhe të qenit financiarisht përgjegjës për jobalancet e shkaktuara;

- g) **Shërbimi i balancimit**- është sigurimi i kapacitetit rezervë i kontraktuar dhe/ose energjia elektrike balancuese, e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin;
- h) **Kode** - rregullat teknike të zhvilluara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në kuadër të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe të aprovuara nga Rregullatori, në pajtueshmëri me Ligjin për Energjinë.
- i) **Kontratë Bilaterale** - Marrëveshje për shitjen e energjisë elektrike tek blerësit, në përputhje me Nenin 22, paragrafin 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
- j) **Operatori i Tregut** - ndërmarrja energjetike e licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji për të operuar me tregun e energjisë elektrike në Kosovë.
- k) **Vartës** - çdo ndërmarrje në pronësi apo e kontrolluar nga një ndërmarrje tjetër, e që definohet sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.
- l) **Furnizues** – ndërmarrje e energjisë elektrike e licencuar për të kryer veprimtari të furnizimit.
- m) **Sistemi i transmetimit** - sistemi i përbërë nga kombinimi i linjave, nënstationeve dhe stabilimenteve të tensionit të lartë që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike;
- n) **Operatori i Sistemit të Transmetimit** - personi fizik, ose juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e rrjetit të transmetimit në një zonë të caktuar përfshirë kurdo që kjo është e mundur, interkonektorët me sistemet tjera, dhe për të garantuar aftësinë afatgjate të rrjetit për të përmbushur kërkesat për transmetimin e energjisë elektrike;
- o) **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes** - personi fizik ose juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, si dhe ku është e mundur interkonektorët e tij me sistemet tjera, si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike;
- p) **Sistemi i shpërndarjes** - kombinim i linjave të energjisë elektrike dhe pajisjeve të energjisë elektrike me tension të mesëm dhe të ulët që shërbejnë për shpërndarjen e energjisë elektrike;
- q) **Legjislacion** – nënkupton Ligji për Energjinë (Ligji nr. 05/L - 081), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 05/L - 084), Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji nr. 05/L - 085) si dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.

2. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptim si termat e përdorur në Legjislacionin në fuqi.

Neni 3 **Të drejtat dhe detyrimet**

1. I Licencuari duhet të veproj në përputhje me dispozitat dhe kushtet e specifikuar në këtë licencë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe ligjet tjera, rregulloret, rregullat dhe kodet në fuqi.
2. I Licencuari duhet të ofroj kapacitetin e tij në mënyrë transparente, jo-diskriminuese dhe të bazuar në treg tek të gjithë konsumatorët në tregjet me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike, duke përfshirë edhe atyre me obligimin e shërbimit publik, në përputhje me Nenin 5 të Ligjit për energjinë elektrike.
3. Në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe kësaj licence, i Licencuari do ta menaxhojë në mënyrë më ekonomike Hidrocentralin e gjenerimit të energjisë elektrike, dhe duhet:
 - 3.1. I të përdorë në centralet e veta energjetike ato burime kryesore të energjisë që i mendon si më të përshtatshme;
 - 3.2. të kyçë centralin elektrik në Sistemin e Transmetimit ose Shpërndarjes sipas rregullave dhe kushteve të përcaktuara në kodet dhe rregullat përkatëse;
 - 3.3. të injektoj energji në Sistemin e Transmetimit ose Sistemin e Shpërndarjes, nën kushtet e specifikuar në kodet relevante dhe rregulloret, në pajtueshmëri me udhëzimet e operatorit të relevant të sistemit;
 - 3.4. shesin energjinë elektrike sipas dispozitave të këtij ligji akteve tjera dhe në veçanti Rregullave të Tregut;
 - 3.5. blejë energjinë elektrike për nevojat e veta;
 - 3.6. faturtoj dhe inkasoj pagesat sipas kontratave të nënshkruara për të gjitha shitjet e energjisë elektrike, kapacitetet, shërbimet ndihmëse dhe shërbimet tjera të kontraktuara;
 - 3.7. të realizojë pagesën e duhur sipas kontratave;
 - 3.8. të pajiset me pajisje matëse adekuate për matjen e energjisë elektrike që hynë në sistem si dhe
 - 3.9. të kryej funksione të tjera të caktuara nga legjislacioni në fuqi dhe kjo licencë.
4. Kapaciteti i instaluar për stabilimentet gjeneruese është **8.3 MW**.
5. Në rast të ndryshimit në kapacitetin prodhues, i Licencuari menjëherë do të njoftoj Rregullatorin.
6. Territori që mbulohet nga kjo licencë është i tërë territori i Republikës së Kosovës.

Neni 4 Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Prodhimit

1. I Licencuari do të përgatisë Pasqyrat Financiare vjetore në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, nxjerrë nga ZRRE-ja dhe do t'i dorëzojë Rregullatorit një kopje të Pasqyrave Financiare të audituara brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiar. Llogaritë e brendshme duhet të jenë të ndara për aktivitetet e prodhimit nga llogaritë e brendshme për aktivitetet e tjera, sikur këto aktivitete të kryheshin nga ndonjë ndërmarrje tjetër. Në rast se i licencuari për arsye objektive nuk mund të përgatis këto pasqyra brenda tre (3) muajve, atëherë jo më vonë se 15 mars, i licencuari duhet të kërkojë nga rregullatori shtyrje afati, por jo më vonë se 30 prill të vitit aktual, për dorëzim të këtyre pasqyrave.
2. I Licencuari do të dorëzojë në Rregullator Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara nga auditor i pavarur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar.
3. I Licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin për aktivitetin e Prodhimit në tërësi, si dhe për aktivitetet tjera. Kontabiliteti rregullativ do të jetë në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet, i cili ndër të tjera mund të specifikojë:
 - 3.1. formën e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm nga llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilanci, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostove, asetëve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë biznes tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis aktiviteteve gjeneruese të konsoliduar dhe ndonjë aktiviteti tjetër;
 - 3.2. natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave të kontabilitetit rregullativ, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, asetëve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuara;
 - 3.3. parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e ngarkesave, shpërndarjes ose alokimit nga ato që janë përdorur në vitin financiar paraprak, përveçse nëse Rregullatori nxjerr më parë udhëzimin relevant ose jep aprovimin për ndryshimin e këtyre bazave.
5. I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga ZRRE-ja dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 5

Shitja e Prodhimit dhe Ndalimi i Ndër-subvencioneve

1. I Licencuari mund të shes kapacitetin dhe/ose energjinë e tij lirshëm tek blerësit nën kushtet dhe afatet, duke përfshirë kushtet e çmimit, të vendosura:
 - 1.1. në marrëveshje bilaterale ndërmjet të Licencuarit dhe blerësit; ose
 - 1.2. sipas rregullave të ndonjë tregu të organizuar në të cilin i Licencuari është pjesëmarrës; përveç nëse i nënshtrohet kërkesave të kufizimit të çmimit sipas Obligimit të Shërbimit Publik të vendosur mbi të Licencuarin, sipas Nenit 19 të kësaj Licence.
2. Gjatë kryerjes së aktivitetit të tij të licencuar, i Licencuari duhet të sigurojë se ngarkesat/çmimet e tij nuk janë rritur apo ulur si rezultat i marrjes apo dhënies së ndonjë ndër-subvencion (direkt apo të tërthortë) nga ose në emër të ndonjë aktiviteti tjetër të tillë të të Licencuarit ose ndonjë personi (ortaku) anëtarit ndërlidhur, korporate apo ndonjë subjekti fizik apo juridik.

Neni 6

Ndalimi i Abuzimit të Pozitës Dominuese

1. Të Licencuarit i ndalohet abuzimit i pozitës së tij dominuese, siç përcaktohet në Nenin 23 të Ligjit për Energjinë dhe legjislacionit në fuqi.
2. Nëse ka dyshim për abuzim nga i Licencuari, në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni, Rregullatori do të njoftoj Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe do të vendos masa administrative dhe gjopa mbi të Licencuarin, siç përshkruhet në Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 7

Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit, Kodet e Matjes dhe legjislacionin tjetër në fuqi

I Licencuari do të veprojë në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit, Kodet e Matjes dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 8

Masat e efijencës

1. Brenda gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Licence, i Licencuari duhet të dorëzoj në Rregullator për informim, një program të masave të propozuara që do të ndërmerren për të ngritur efijencën e prodhimit nga njësitë e tij gjeneruese, në pajtueshmëri me Nenin 7, paragrafi 3 të Ligjit për energjinë elektrike dhe legjislacionit

sekondar apo udhëzimeve të lëshuara nga Rregullatori apo ndonjë organ tjetër kompetent.

2. Programi i masave të specifikuara në paragrafin 1 të këtij neni duhet të shoqërohet nga një analizë e kostove dhe përfitimeve të masave të propozuara, dhe faktorët e marrë parasysh nga i Licencuari.
3. Për aq gjatë sa Rregullatori kërkon, i Licencuari duhet t'i raportoj Rregullatorit deri më 31 dhjetor të secilit vit mbi:
 - 3.1 progresin drejt implementimit të masave të propozuara, sipas kushteve të paragrafit 1 të këtij neni, dhe
 - 3.2 përfitimet e efikasitetit që kanë rezultuar nga masat e implementuara.

Neni 9 **Dispeçingu Qendror**

1. I Licencuari do të paraqesë të gjithë njësitë e gjenerimit në dispozicion në Dispeçingun Qendror nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, kurdo që kërkohet Dispeçingu Qendror kërkohet sipas Kodit të Rrjetit Elektrik dhe Rregullave të Tregut.
2. I Licencuari, do t'i sigurojë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të gjitha informacionet e kërkuara në mënyrë që ta mundësojë operimin e sistemit të Dispeçingut Qendror, në kohën dhe mënyrën siç parashihet me Kodin e Rrjetit.
3. Në këtë Nen:

"Në dispozicion" - nënkupton njësitë e gjenerimit që është në dispozicion në përputhje me Kodin e Rrjetit.

"Dispeçingu Qendror" - procesi i planifikimit dhe lëshimit të udhëzimeve direkte për dispeçimin e njësive të gjenerimit të disponueshme nga Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

"Transferim Ndërlidhës" - rrjedha e energjisë elektrike përgjatë një ndërlidhësi.

Neni 10 **Shërbimet Ndhmëse dhe balancuese**

1. I Licencuari do t'i ofroj shërbimet ndhmëse dhe shërbimin balancues prej çdo njësie gjenerimi te tek çdo operator i sistemit që kërkon shërbime të tilla në pajtueshmëri me dispozitat e kodeve të aplikueshme.

2. Kur kushtet e ofruara nga i Licencuari janë të pranueshme për Operatorin e Sistemit atëherë ata mund të lidhin marrëveshje.
3. Nëse operatori i sistemit konteston kushtet e ofruara nga i Licencuari sipas paragrafit 2 të këtij Neni, Rregullatori do të përcaktojë çdo kusht të marrëveshjes që është në mospërputhje sipas Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë.
4. Nëse operatori i sistemit procedon në bazë të kushteve të përcaktuar nga Rregullatori, i Licencuari duhet të hyjë në marrëveshje për shërbimet ndihmëse ose shërbimin balancues dhe do ta zbatojë atë në përputhje me kushtet e saj.
5. I Licencuari sipas kërkesës së Rregullatorit, do t'i dorëzojë Rregullatorit raportin me detajet si në vijim:
 - 5.1. çmimet e ofruara për sigurimin e Shërbimeve Ndhmëse dhe/ose shërbimet balancuese nga çdo njësi gjeneruese të Licencuarit; dhe
 - 5.2. detajet lidhur me koston e të Licencuarit për sigurimin e Shërbimeve Ndhmëse dhe/ose shërbimin balancues.

Neni 11 **Caktimi i Operatorit**

1. I Licencuari do të emërojë një person të kualifikuar dhe me përvojë përkatëse që të jetë përgjegjës për operimin e çdo njësie gjeneruese të përfshirë në licencë. Para emërimit të ndonjë personi të tillë, i Licencuari duhet të sigurojë pëlqimin me shkrim nga ZRRE-ja.
2. Nëse personi nuk është më kompetent që të ushtroj atë funksion, Rregullatori përmes njoftimit me shkrim dhënë të Licencuarit, mund të kërkojë zëvendësimin e atij personi.
3. Rregullatori sipas paragrafit 2 të këtij Neni, do të përcaktojë se cilët kritere do të merren parasysh në shqyrtimin e kompetencës, në përputhje me kriteret që lidhen me njohuritë dhe aftësitë profesionale, përvojën, si dhe me kriteret që lidhen me kërkesën për mbrojtje dhe sigurim të prodhimit.

Neni 12 **Rregullat e Tregut**

1. I Licencuari do të veprojë në përputhje me Rregullat e Tregut në fuqi.
2. I Licencuari do të ketë përgjegjësi balancuese dhe do të kryej të gjitha obligimet e tij në mënyrë të shpejtë, të plotë dhe të saktë, në pajtueshmëri me legjislacionin, kodet dhe rregullat në fuqi.

Neni 13

Shëndeti dhe Siguria

1. I Licencuari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të mbrojtur personat nga lëndimet dhe dëmtimet që mund t'u shkaktohen atyre nga ana e të Licencuarit gjatë ushtrimit të aktivitetit të prodhimit, në përputhje me Legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari në përputhje me legjislacionin në fuqi do të kryej kontroll (auditim) teknik dhe të sigurisë të kapaciteteve të gjenerimit në baza vjetore, dhe rezultatet e një kontrolli të tillë do t'i dërgojë në Rregullatorit, sa herë që kjo kërkohet nga Rregullatori.

Neni 14

Mjedisi

1. I Licencuari t'i dërgojë Rregullatori kopje të Lejes Mjedisore për mbrojtjen e mjedisit dhe dokumentet tjera të lëshuar nga Ministria përkatëse për mjedis. I Licencuari duhet të veprojë në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.
2. I Licencuari do t'i raportojë ZRRE-së për çdo vit mbi aktivitetin e tij mjedisor.

Neni 15

Puna

I Licencuari, lidhur me marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë do të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

Neni 16

Tjetërsimi dhe Heqja e Aseteve Relevante të të Licencuarit

1. I Licencuari do të zhvilloj dhe mirëmbaj një regjistër të të gjitha asetëve relevante dhe duhet ta dorëzoj atë në Rregullator, së bashku me ndonjë ndryshim në regjistër, jo më vonë se 31 Janari, i çdo viti.
2. I Licencuari nuk do të tjetërsoi apo heqë dorë nga kontrolli funksional mbi ndonjë aset relevant, nëse kjo do të ndikojë në aftësinë për t'i kryer obligimet e tij apo nëse aset i ka vlerën e zëvendësimit mbi njëqindmijë euro (100,000.00 €).
3. Në rastet kur i Licencuari dëshiron të tjetërsoi asetet apo pasuritë tjera që përdoret në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, i Licencuari është i detyruar të njoftojë me shkrim ZRRE-në. I Licencuari mund të bëjë tjetërsimin e ndonjë asemi pas aprovimit me shkrim nga ZRRE-ja.

4. Në këtë Nen:

“Tjetërsimi” - çdo shitje, transferim, dhurim, dhënien me qira, hua, hipotekë, ngarkim, kufizim mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor) ose ndonjë ngarkesë tjetër, si dhe lejimin e ndonjë ngarkese ndaj një aktiviteti tjetër të të Licencuarit ose pale të tretë.

“Aset Relevant” - konsiderohet të jetë çdo pronë apo pajisje nga i Licencuari në ushtrimin e aktiviteteve të dhëna me këtë Licencë, përfshirë çdo interes ligjor apo të dobishëm për ndonjë tokë apo objekt, dhe çdo pronësi intelektuale.

Neni 17 **Obligimi i Sigurimit**

1. I licencuari do të bëjë sigurimin e aseteve në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
2. I licencuari do të lidhë kontrata për sigurimin e aseteve të gjenerimit dhe për pajisjet që përdoren për prodhim të energjisë elektrike. Kontratat e tilla do t’i dërgohen Rregullatorit për rishikim në baza vjetore.

Neni 18 **Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit**

1. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa nuk aprovohet nga Rregullatori.
2. I Licencuari do të njoftojë Rregullatorin për çdo ndryshim të Strukturës Organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t’i bëhet Rregullatorit jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.

Neni 19 **Obligimet e Shërbimit Publik**

I Licencuari do të kryej çdo obligim të shërbimit publik që mund t’i vendoset nga Rregullatori, në përputhje me Nenin 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 20 **Sigurimi i Informacioneve ndaj Rregullatorit**

1. I Licencuari do t’i dorëzojë Rregullatorit informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet që Rregullatori mund t’i konsiderojë të nevojshme.

2. I Licencuari do të dorëzojë në Rregullator raporte mbi veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe pajtueshmërinë me kushtet Licencës, në pajtim me Doracaku e Raportimit për Sektorin e Energjisë, të miratuar nga Rregullatori, si dhe kërkesave të Rregullatorit.
3. Nëse i Licencuari, në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale, kërkon që një informacion i caktuar të konsiderohet si konfidencial, atëherë është i obligim i tij që të shënjojë atë informacion si konfidencial dhe të arsyetojë kërkesën e tij te Rregullatori. Rregullatori do të shqyrtojë kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
4. I Licencuari do të raportoj në Rregullator në çdo kohë lidhur me rrethanat e shitjes tek blerësit, duke përfshirë (pa kufizim) volumet, faktorët e ngarkesës, kushtet e përfundimit, afatet dhe kohëzgjatjen e marrëveshjeve përkatëse.
5. Zyra e Rregullatorit për Energji ka të drejtë të kërkojë nga i licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me Nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
6. I Licencuari do të emërojë një person kryesor përmes të cilit do të ketë lidhje komunikimi me Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Operatorin e Tregut. Adresa, numri i telefonit, faksit ose adresa elektronike e personit të tillë do t'i dërgohet Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Tregut.
7. I Licencuari sa herë që kërkohet do t'i dërgojë Rregullatorit çdo kopje të Kontratave të nënshkruara në lidhje me tregtinë ndër-kufitare me energji elektrike, kontratat për furnizim, marrëveshjet për blerje të energjisë elektrike dhe çdo kontratë të nënshkruar në pajtim me Marrëveshjen për Blerje të Energjisë Elektrike.
8. I Licencuari duhet t'i dërgojë Rregullatorit detajet për çdo ndryshim në informata që janë dërguar gjatë aplikimit për këtë licencë.
9. Në këtë Nen:

"Informacion" - materiali që në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga Rregullatori.

Neni 21

Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës

1. Rregullatori mund të vazhdojë, modifikojë, pezullojë dhe ndërpresë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

2. Rregulatori mund të transferojë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, por duke siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të një transferimi të tillë.

Neni 22

Taksat

I Licencuari do t'i paguajë Rregullatorit çdo taksë fillestare dhe vjetore të caktuar sipas Rregullës për Taksat, të nxjerrë nga ZRRE-ja.

Neni 23

Masat Administrative dhe Gjobat

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit në fuqi përfshirë Rregullat e nxjerra nga ZRRE-ja apo Nenet dhe Kushtet e kësaj licence apo udhëzimet e dhëna të licencuarit nga ana e Rregullatorit, Rregulatori ka kompetenca t'i vendos të Licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.
3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

Neni 24

Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga Rregullatori.
2. Vendimet e Rregullatorit lidhur me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferim të licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të kontestohen nga i Licencuari në Gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.

Neni 25

Hyrja në fuqi

1. Në pajtim me Nenin 36 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë e ndryshuar/modifikuar, tani me numër licence **ZRRE/Tr_01/Li_09/17** i lëshohet ndërmarrjes **KELKOS ENERGY SH.P.K**, për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, dhe hynë në fuqi me datë **27.04.2017**.
2. Licenca e lëshuar me datë **04 Tetor 2006** (Nr. i Licencës ERO/Li_09/06), e transferuar me datë 30 qershor 2009 (Nr. i Licencës ZRRE/Tr_01/Li_09/06), e modifikuar me datë 18.07.2012 (Nr. i Licencës ZRRE/Tr_01/Li_09/12), tani e modifikuar me datë 27.04.2017 (Nr. i Licencës ZRRE/Tr_01/Li_09/17), do të vazhdojë të jetë e vlefshme gjatë kohëzgjatjes teknike të pjesëve kryesore të centralit ekzistues që përdoren për kryerjen e aktiviteteve relevante, deri më **29 prill 2024**, (sa zgjatë Marrëveshja mbi Qiranë dhe Marrëveshja mbi Blerjen e Energjisë e nënshkruar me KEK-un më 29 Prill 2004).

E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji më: _____



Nënshkruar (në emër të Bordit të Rregullatorit) U.D Krenar Bujupi: _____

Nënshkruar më: 27.04.17.